

## FTESË PËR OFERTË

Numri i prokurimit: RFO-0013-03-2019

**I. Autoriteti kontraktues:** Banka për Biznes, Sh.A.

**II. Lënda e kontratës:** "Shpërndarja e dërgesave të ndryshme lokale në degët dhe nëndegët e Bankës"

**III. Procedura e përdorur:** Ftesë për ofertë

**IV. Kushtet e ofertimit:**

a) Afati kohor dhe vendi i dorëzimit të ofertave:

- Afati i fundit për dorëzimin e ofertës në bankë është **20 mars 2019** deri në ora **14:00**.
- Adresa: Zyra e Prokurimit në Qendër, rruga e UÇK-së nr. 153, Prishtinë, Kosovë.

b) Oferta financiare dhe Oferta teknike duhet të ndahen nga njëra tjetra nëpër pliko (zarfa) të veçantë dhe të dyja së bashku me rastin e dorëzimit të ofertës duhet të vendosen në një zarf të përbashkët, në të cilin duhet të shënohet vetëm numri referues dhe përshkrimi i tenderit për të cilin e dorëzoni ofertën tuaj.

Vërejtje:

- Kompania ofertuese duhet të dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm ligjor – çertifikatën e regjistrimit të biznesit dhe certifikatën e numrit fiskal.
- Banka për Biznes është deklarues i TVSH-së. Të gjitha çmimet e deklaruara nga ofertuesit të cilët janë deklarues të TVSH-së duhet që ta listojnë ndarësi vlerën e TVSH-së. Çmimet të cilat nuk e kanë të ndarë vlerën e TVSH-së do të nënkuptohet se ajo është e përfshirë në çmim.
- Çmimet duhet të kuotohen në Euro.
- Kompania ofertuese duhet të paraqesë referencat e saja për shërbime të ngjashme.
- Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë katër muaj (120 ditë) nga dita e dorëzimit.
- Oferta duhet të dorëzohet në gjuhën shqipe.
- Banka për Biznes ka të drejtë që të anulohë kërkesën dhe/ose të ndryshojë karakteristikat e kërkesës dhe t'i ftojë sërish kompanitë që të i sjellin prapë ofertat tyre.
- Dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merret parasysh.

Dokumentet për aplikim mund të kërkohen nga data **06 mars 2019** në email adresën [prokurimi@bpbbank.com](mailto:prokurimi@bpbbank.com) dhe atë çdo ditë pune gjatë orës 10:00-15:00.